



Originali: **anglisht**

Nr.: **ICC-02/05-01/09**

Data: 4 mars 2009

DHOMA PARA-GJYQËSORE I

Para: Gjyqtares Akua Kuenyehia, Kryetare e Trupit Gjykues
Gjyqtares Anita Ušacka
Gjyqtares Sylvia Steiner

SITUATA NË DARFUR, SUDAN

NË LËNDËN

**PROKURORI kundër OMAR HASSAN AHMAD AL BASHIR-it ("OMAR AL
BASHIR")**

Dokument Publik

Urdhër Arresti për Omar Hassan Ahmad Al Bashir-in

Të njoftohen me dokumentin në përputhje me rregulloren 31 të *Rregulloreve të Gjykatës*:

Zyra e Prokurorit

Z. Luis Moreno-Ocampo, Prokuror
Z. Essa Faal, Avokat i Lartë Gjyqësor

Avokati i Mbrojtjes

Përfaqësuesit Ligjorë të Viktimave

Përfaqësuesit Ligjorë të Paditësve

Viktimat e Papërfaqësuar

**Paditësit e Papërfaqësuar për
Pjesëmarrje/Zhdëmtim**

Zyra e Avokatit Publik për Viktimat

Zyra e Avokatit Publik për Mbrojtjen

Përfaqësuesit e Shteteve

Miq të Gjykatës

SEKRETARIA

Sekretarja e Gjykatës
Znj. Silvana Arbia

Seksioni për Mbështetjen e Mbrojtjes

Njësia për Viktima dhe Dëshmitarë

Seksioni i Paraburgimit

Seksioni i Pjesëmarrjes dhe Zhdëmtimit të Viktimave

Të tjerë

DHOMA PARA-GJYQËSORE I e Gjykatës Penale Ndërkombëtare (“Dhoma” dhe “Gjykata”, përkatësisht);

PASI KA SHQYRTUAR “Prosecution’s Application under Article 58” (“Aplikacioni i Prokurorisë”), dorëzuar nga Prokuroria më 14 korrik 2008 në regjistrin e situatës në Darfur, Sudan (“situata në Darfur”) duke kërkuar lëshimin e një urdhër arresti për arrestimin e Omar Hassan Ahmad Al Bashir-it (më tej “Omar Al Bashir”) për gjenocid, krime kundër njerëzimit dhe krime të luftës;¹

PASI KA SHQYRTUAR materialin mbështetës dhe informacionin tjetër të paraqitur nga Prokuroria;²

DUKE MARRË SHËNIM “Decision on the Prosecution’s Request for a Warrant of Arrest against Omar Hassan Ahmad Al Bashir”³ në të cilin Dhoma ishte e bindur se ka baza të arsyeshme të besohet se Omar Al Bashir-i është penalisht përgjegjës sipas nenit 25(3)(a) të Statutit si bërës indirekt, apo si bërës indirekt bashkë me të tjerë,⁴ për krime të luftës kundër njerëzimit dhe se arrestimi i tij duket të jetë i domosdoshëm sipas nenit 58(1)(b) të *Statutit të Romës* (“Statuti”);

DUKE MARRË SHËNIM nenet 19 dhe 58 të Statutit;

DUKE MARRË PARASYSH se, në bazë të materialit të sjellë nga Prokuroria në mbështetje të Aplikacionit të Prokurorisë dhe pa paragjykim ndaj ndonjë përcaktimi të pastajmë që mund të bëhet sipas nenit 19 të Statutit, lënda kundër Omar Al Bashir-it bie nën jurisdiksionin e Gjykatës;

¹ ICC-02/05-151-US-Exp; ICC-02/05-151-US-Exp-Anekset 1-89; Corrigendum ICC-02/05-151-US-Exp-Corr dhe Corrigendum ICC-02/05-151-US-Exp-Corr- Anekset 1 & 2; dhe Versioni i redaktuar publik ICC-02/05-157 dhe ICC-02/05-157-Aneksi A.

² ICC-02/05-161 dhe ICC-02/05-161-Conf- Anekset A-J; ICC-02/05-179 dhe ICC-02/05-179-Conf-Exp- Anekset 1-5; ICC-02/05-183-US-Exp dhe ICC-02/05-183-Conf-Exp- Anekset A-E.

³ ICC-02/05-01/09-1.

⁴ *Shih* Opinionin Pjesërisht të Ndarë të Gjyqtarës Anita Ušacka ndaj “Decision on the Prosecution’s Application for a Warrant of Arrest against Omar Hassan Ahmad Al Bashir”, Pjesa IV.

DUKE MARRË PARASYSH se, në bazë të materialit të sjellë nga Prokuroria në mbështetje të Aplikacionit të Prokurorisë, nuk ka shkak të dukshëm apo faktor të vetëkuptueshëm që ta shtyjë Dhomën të ushtrojë diskrecionin e saj sipas nenit 19(1) të Statutit për të përcaktuar në këtë fazë pranueshmërinë e lëndës kundër Omar Al Bashir-it;

DUKE MARRË PARASYSH se ka baza të arsyeshme të besohet se prej marsit të vitit 2003 deri së paku më 14 korrik 2008, një konflikt i tejzgjatur jo i një karakteri ndërkombëtar brenda kuptimit të nenit 8(2)(f) të Statutit ka ekzistuar në Darfur midis Qeverisë së Sudanit ("QS") dhe disa grupeve të organizuara të armatosura, veçanërisht Lëvizjes/Armatës Çlirimtare Sudaneze ("L/AÇS") dhe Lëvizjes Drejtësi dhe Barazi ("LDB");

DUKE MARRË PARASYSH se ka baza të arsyeshme të besohet: (i) se pak kohë pas sulmit mbi aeroportin El Fasher në prill të vitit 2003, QS lëshoi një thirrje të përgjithshme për mobilizimin e Milicisë Janjaweed në përgjigje ndaj aktiviteteve të L/AÇS-së, LDB-së dhe grupeve të tjera të armatosura kundërshtare në Darfur, dhe aty e pas udhëhoqi, përmes forcave të QS-së, duke përfshirë Forcat e Armatosura Sudaneze dhe aleatën e tyre Milicinë Janjaweed, Forcën Policore Sudaneze, Shërbimin e Inteligjencës dhe Sigurisë Nacionale ("SHISN") dhe Komisionin për Ndihmë Humanitare ("KNH"), një fushatë kundër kryengritjes gjithandej regjionit të Darfurit kundër grupeve kundërshtare të armatosura të përmendura; dhe (ii) se fushata kundër kryengritjes ka vazhduar deri në ditën e dorëzimit të Aplikacionit të Prokurorisë më 14 korrik 2008;

DUKE MARRË PARASYSH se ka baza të arsyeshme të besohet: (i) se një komponentë bërthamë e fushatës së QS-së kundër kryengritjes ishte sulmi i paligjshëm mbi pjesën e popullatës civile të Darfurit – që u përkiste kryesisht grupeve Fur, Masalit dhe Zaghawa⁵ – që perceptoheshin nga QS si të afërta me

⁵ *Shih* Opinionin Pjesërisht të Ndarë të Gjyqtarës Anita Ušacka ndaj "Decision on the Prosecution's Application for a Warrant of Arrest against Omar Hassan Ahmad Al Bashir", Pjesa III. B.

L/AÇS-në, LDB-në dhe grupet e tjera të armatosura kundërshtare të QS-së në konfliktin e armatosur që po vazhdonte në Darfur; dhe (ii) se, si pjesë e kësaj komponente bërthamë e fushatës kundër kryengritjes, forcat e QS-së kanë kryer sistematikisht vepra të plaçkitjes pas marrjes së qyteteve dhe fshatrave që u nënshtroheshin sulmeve të tyre;⁶

DUKE MARRË PARASYSH, prandaj, se ka baza të arsyeshme të besohet se pak kohë pas sulmit mbi aeroportin El Fasher të prillit 2003 deri më 14 korrik 2008, krime lufte brenda kuptimit të neneve 8(2)(e)(i) dhe 8(2)(e)(v) të Statutit janë kryer nga forcat e QS-së, duke përfshirë Forcat e Armatosura Sudaneze dhe aleatën e tyre Milicinë Janjaweed, Forcën Policore Sudaneze, SHISN-në dhe KHN-në, si pjesë të fushatës së përmendur më sipër të QS-së kundër kryengritjes;

DUKE MARRË PARASYSH, më tej, se ka baza të arsyeshme për të besuar se, përderisa ishte komponentë bërthamë e fushatës së QS-së kundër kryengritjes, ishte politikë e QS-së për të sulmuar në mënyrë të paligjshme atë pjesë të popullatës civile të Darfurit – që u përkiste kryesisht grupeve Fur, Malasit dhe Zaghawa – që perceptohej nga QS se ishte e afërt me L/AÇS-në, LDB-në dhe grupet e tjera të armatosura që kundërshtonin QS-në në konfliktin e armatosur që po vazhdonte në Darfur;

DUKE MARRË PARASYSH se ka baza të arsyeshme të besohet se sulmi i paligjshëm mbi pjesën e sipërpërmendur të popullatës civile të Darfurit ishte (i) i përgjithshëm, pasi ndikonte, së paku, tek qindra mijëra individë dhe ndodhi në breza të mëdhenj të territorit të regjionit të Darfurit; dhe (ii) sistematik, pasi që aktet e

⁶ Duke përfshirë *midis tjerash* (i) sulmin e parë mbi Kodoom më 15 gusht 2003 apo rreth kësaj date; (ii) sulmin e dytë mbi Kodoom më 31 gusht 2003 ose rreth kësaj date; (iii) sulmin mbi Bindisi më 15 gusht 2003 ose rreth kësaj date; (iv) sulmin nga ajri mbi Mukjar midis gushtit dhe shtatorit 2003; (v) sulmin mbi Arawala më 10 dhjetor 2003 ose rreth kësaj date; (vi) sulmin mbi qytetin Shattaya dhe fshatrat përreth (duke përfshirë Kailek-un) në shkurt 2004; (vii) sulmin mbi Muhajeriya më ose rreth datës 8 tetor 2007; (viii) sulmet mbi Saraf Jidad më 7, 12 dhe 24 janar 2008; (ix) sulmin mbi Silea më 8 shkurt 2008; (x) sulmin mbi Sirba më 8 shkurt 2008; dhe (xi) sulmin mbi Abu Suruj më 8 shkurt 2008; (xii) sulmin mbi Jebel Moon midis 18 dhe 22 shkurtit 2008.

involuara të dhunës ndoqën, në një masë të konsiderueshme, një model të ngjashëm;

DUKE MARRË PARASYSH se ka baza të arsyeshme të besohet se, si pjesë e sulmit të paligjshëm të QS-së mbi pjesën e sipërpërmendur të popullatës civile të Darfurit dhe me dijeni të një sulmi të tillë, qindra mijëra civilë, që u përkisnin në radhë të parë grupeve Fur, Malasit dhe Zaghawa, iu nënshtruan akteve të vrasjes dhe shfarosjes nga forcat e QS-së, gjithandej regjionit të Darfurit;⁷

DUKE MARRË PARASYSH se ka po ashtu baza të arsyeshme të besohet se, si pjesë e sulmit të paligjshëm të QS-së mbi pjesën e sipërpërmendur të popullatës së Darfurit dhe me dijeni për një sulm të tillë, nga forcat e QS-së iu nënshtruan, gjithandej regjionit të Darfurit, (i) qindra mijëra civilë, që u përkisnin grupeve Fur, Malasit dhe Zaghawa, akteve të zhvendosjes me forcë;⁸ (ii) mijëra gra civile, që u përkisnin këtyre grupeve, akteve të përdhunimit;⁹ dhe (iii) civilët, që u përkisnin në radhë të parë këtyre grupeve, akteve të torturës;¹⁰

⁷ Përfshirë në *midis tjerash* (i) qytetet Kodoom, Bindisi, Mukjar dhe Arawala dhe fshatrat përreth në Ēadi Salih, lokalitetet Mukjar dhe Garsila-Deleig në Darfurin Perëndimor midis gushtit dhe dhjetorit 2003; (ii) qytetet Shattaya dhe Kailek në Darfurin Jugor në shkurt dhe mars 2004; (iii) midis 89 dhe 92 kryesisht qytete të grupeve Zaghawa, Masalit dhe Misseriya Jebel dhe fshatra në Lokalitetin Buram në Darfurin Jugor midis nëntorit 2005 dhe shtatorit 2006; (iv) qyteti Muhajeriya në lokalitetin Yasin në Darfurin Jugor më ose rreth 8 tetorit 2007; (v) qytetet Saraf Jidad, Abu Suruj, Sirba, Jebel Moon dhe Silea në lokalitetin Kulbus në Darfurin Perëndimor midis janarit dhe shkurtit 2008; dhe (vi) rajonet Shegeg Karo dhe al-Ain në maj 2008.

⁸ Përfshirë në *midis tjerash* (i) qytetet Kodoom, Bindisi, Mukjar dhe Arawala dhe fshatrat përreth në Ēadi Salih, lokalitetet Mukjar dhe Garsila-Deleig në Darfurin Perëndimor midis gushtit dhe dhjetorit 2003; (ii) qytetet Shattaya dhe Kailek në Darfurin Jugor në shkurt dhe mars 2004; (iii) midis 89 dhe 92 kryesisht qytetet Zaghawa, Masalit dhe Misseriya Jebel dhe fshatrat në Lokalitetin Buram në Darfurin Jugor midis nëntorit 2005 dhe shtatorit 2006; (iv) qyteti Muhajeriya në lokalitetin Yasin në Darfurin Jugor më ose rreth 8 tetorit 2007; dhe (v) qytetet Saraf Jidad, Abu Suruj, Sirba, Jebel Moon dhe Silea në lokalitetin Kulbus në Darfurin Perëndimor midis janarit dhe shkurtit 2008.

⁹ Përfshirë në *midis tjerash* (i) qytetet Bindisi dhe Arawala në Darfurin Perëndimor midis gushtit dhe dhjetorit 2003; (ii) qytetin Kailek në Darfurin Jugor në shkurt dhe mars 2004; dhe (iii) qytetet Sirba dhe Silea në lokalitetin Kulbus në Darfurin Perëndimor midis janarit dhe shkurtit 2008.

¹⁰ Përfshirë në *midis tjerash* (i) qytetin Mukjar në Darfurin Perëndimor në gusht 2003; (ii) qytetin Kailek në Darfurin Perëndimor në mars 2004; dhe (iii) qytetin Jebel Moon në lokalitetin Kulbus në Darfurin Perëndimor në shkurt 2008.

DUKE MARRË PARASYSH prandaj se ka baza të arsyeshme të besohet se, pak kohë pas sulmit mbi aeroportin El Fasher të prillit 2003 deri më 14 korrik 2008, forcat e QS-së, përfshirë Forcat e Armatosura Sudaneze dhe aleaten e tyre Milicinë Janjaweed, Forcën Policore Sudaneze, SHISN-në dhe KHN-në, kryen krime kundër njerëzimit që përbëheshin nga vrasje, shfarosje, zhvendosje me forcë, torturë dhe përdhunim, brenda kuptimit të neneve 7(1)(a), (b), (d), (f) dhe (g) përkatësisht të Statutit, gjithandej regjionit të Darfurit;

DUKE MARRË PARASYSH se ka baza të arsyeshme të besohet se Omar Al Bashir-i ka qenë *de jure* dhe *de facto* President i Shtetit të Sudanit dhe Krye-komandant i Forcave të Armatosura të Sudanit nga marsi 2003 deri më 14 korrik 2008, dhe se, në atë pozicion, ka luajtur rol themelor në koordinimin, me liderë të tjerë të rangut të lartë sudanezë, në projektimin dhe zbatimin e fushatës së sipërpërmendur të QS-së kundër kryengritjes;

DUKE MARRË PARASYSH, më tej, se Dhoma gjen, në alternativë, se ka baza të arsyeshme të besohet: (i) se roli i Omar Al Bashir-it ka shkuar përtej koordinimit e projektimit dhe zbatimit të planit të përbashkët; (ii) se ai ka qenë në kontroll të plotë të të gjitha degëve të “apararit” të Shtetit të Sudanit, përfshirë Forcat e Armatosura Sudaneze dhe aleaten e tyre Milicinë Janjaweed, Forcën Policore Sudaneze, SHISN-në dhe KHN-në; dhe (iii) se ai ka përdorur kontrollin e tillë për të siguruar zbatimin e planit të përbashkët;

DUKE MARRË PARASYSH se, për arsyet e mësipërme, ka baza të arsyeshme të besohet se Omar Al Bashir-i është penalisht përgjegjës si një bërës indirekt, apo si një bërës indirekt bashkë me të tjerë,¹¹ sipas nenit 25(3)(a) të Statutit, për:

¹¹ *Shih* Opinionin Pjesërisht të Ndarë të Gjyqtarës Anita Ušacka ndaj “Decision on the Prosecution’s Application for a Warrant of Arrest against Omar Hassan Ahmad Al Bashir”, Pjesa IV.

- i. drejtim me qëllim të sulmeve kundër popullatës civile si e tillë apo kundër civilëve individualë që nuk merren pjesë drejtpërsëdrejti në armiqësi si një krim lufte, brenda kuptimit të nenit 8(2)(e)(i) të Statutit;
- ii. plaçkitje si një krim lufte brenda kuptimit të nenit 8(2)(e)(v) të Statutit;
- iii. vrasje si një krim lufte kundër njerëzimit, brenda kuptimit të nenit 7(1)(a) të Statutit;
- iv. shfarsosje si një krim kundër njerëzimit, brenda kuptimit të nenit 7(1)(b) të Statutit;
- v. zhvendosje me forcë si një krim kundër njerëzimit, brenda kuptimit të nenit 7(1)(d) të Statutit;
- vi. torturë si një krim kundër njerëzimit, brenda kuptimit të nenit 7(1)(f) të Statutit; dhe
- vii. përdhunim si një krim kundër njerëzimit, brenda kuptimit të nenit 7(1)(g) të Statutit;

DUKE MARRË PARASYSH se, sipas nenit 58(1) të Statutit, arrestimi i Omar Al Bashir-it duket i domosdoshëm në këtë fazë për të siguruar (i) që ai të paraqitet para Gjykatës; (ii) që ai të mos pengojë apo rrezikojë hetimin në vazhdim të krimeve për të cilat ai pretendohet të jetë përgjegjës sipas Statutit; dhe (iii) që ai të mos vazhdojë me kryerjen e krimeve të sipërpërmendura;

PËR KËTO ARSYE,

NË KËTË MËNYRË LËSHON:

URDHËR ARRESTI për **OMAR AL BASHIR-in**, mashkull, i cili është shtetas i Shtetit të Sudanit, i lindur më 1 janar 1944 në Hoshe Bannaga, Shendi Governorate, në Sudan, anëtar i fisit Jaáli të Sudanit Verior, President i Republikës së Sudanit që nga vendosja e tij në këtë post nga RCC-NS /Revolutionary Command Council for National Salvation – Këshilli Komandues Revolucionar për Shpëtimin Kombëtar/ më

16 tetor 1993 dhe i zgjedhur si i tillë suksesivisht prej 1 prillit 1996 dhe emri i të cilit po ashtu shkruhet Omar al-Bashir, Omer Hassan Ahmed El Bashire, Omar al-Bashir, Omar al-Beshir, Omar el-Bashir, Omer Albasheer, Omar Elbashir dhe Omar Hassan Ahmad el-Béshir.

Hartuar në anglisht, arabisht dhe frëngjisht, versioni në anglisht është autoritativ.

/nënshkrimi/

Gjyqtarja Akua Kuenyehia
Kryetare e Trupit Gjykues

/nënshkrimi/

Gjyqtarja Anita Ušacka

/nënshkrimi/

Gjyqtarja Silvia Steiner

E mërkurë, 4 mars 2009

Në Hagë, Holandë